



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.13/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Ramush Bardiqi, dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Arbër Vukli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Pejë, parashtuar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkeljen e procedurës së zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit Komunal të Pejës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa Anr.13/2026 datë 19.02.2026, e Arbër Vukli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Pejë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkeljen e procedurës së zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit Komunal të Pejës.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.13/2026 me datën 19.02.2026, përmes postes, nga Arbër Vukli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i cili thekson se nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, në Kuvendin Komunal të Pejës janë dorëhequr një anëtare femër dhe një anëtar mashkull. Tutje në ankesë theksohet se subjekti politik ka pasur gjithsej 7 ulëse (4 meshkuj dhe 3 femra), duke përmbyshur kuotën gjinore, dhe se sipas nenit 10, paragrafi 10,3, pika a) të Ligjit nr. 03/L-072 dhe nenit 3, pika 3.7.1 të Udhëzimit Administrativ nr.01/20217, zëvendësimi duhet të bëhet nga kandidati i radhës i së njëjtës gjini nga lista e rirenditur e të njëjtit subjekt politik. Parashtruesi i ankesës thekson se pas dorëheqjes së anëtarit mashkull, kandidati i parë mashkull në listën e rirenditur jam unë, Arbër Vukli, dhe se në të gjitha rastet e mëhershme të zëvendësimeve në Komunën e Pejës është vepruar në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-072 dhe UA nr. 01/2017, duke respektuar parimin e zëvendësimit sipas gjinisë, vetëm në rastin tim organet përkatëse po veprojnë ndryshe, përkatësisht nuk po zbatojnë dispozitat ligjore në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë. Po ashtu parashtruesi i ankesës thekson se jam kontaktuar me telefon më 09.02.2026, për paraqitje lidhur me pranimin e mandatit dhe jam paraqitur fizikisht më 09.02.2026 dhe 10.02.2026, dhe se nuk më është dorëzuar asnjë shkresë zyrtare për deklaram dhe nuk më është mundësuar deklarimi me shkrim sipas

procedurës së paraparë nga KQZ, nuk kam pranuar vendim zyrtar me shkrim nga KQZ apo KKZ, si dhe kam dërguar email-e zyrtare institucioneve përkatëse, të cilat kanë mbetur pa përgjigje. Në ankese ceket se ka moszbatim të dispozitave ligjore për zëvendësim sipas gjinisë, trajtim i pabarabartë krahasuar me rastet e tjera të zëvendësimit, mosdhënie e mundësisë për deklaram me shkrim, mungesë transparence dhe mos nxjerrje e vendimit zyrtar me shkrim, cenim i të drejtës sime për mandat në përputhje me ligjin. Parashtruesi i ankesës kërkon konstatimin e shkeljes së nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-072 dhe UA nr. 01/2017, pezullimin e çdo vendimi apo veprimi që bie ndesh me dispozitat ligjore deri në vendimin përfundimtar, detyrimin e organit kompetent për zbatim korrekt të procedurës së zëvendësimit sipas gjinisë, njoftimin tim me vendim të arsyetuar me shkrim.

Ankesës ka bashkangjitur kopjet e email-eve të dërguara.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje, LVV", në Pejë, në zgjedhjet lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, ka fituar 7 mandate pre tyre 4 burra dhe 3 gra. KQZ, më datën 13.02.2026, me numër të protokollit Nr.077-262/2026, ka pranuar kërkesë nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Pejë, për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendit z. Bujar Agusholli, i cili ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të kuvendit për arsye Ligjit për Zyrtarët Publik, si dhe kërkesë për zëvendësimin e anëtares Rrezarta Dresha Berisha (shih të bashkangjitur vendimet e emërimit të anëtarëve të kuvendit komunal). Bazuar në nenin 8, paragrafit 4, në ndërlidhje me paragrafin 3, të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartazi që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate (ku ndarja bëhet në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidates më të votuar). Në kuptim të nenit 8 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. Neni 8.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%. Një përcaktim i tillë është rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit në rastet KI45/20 dhe KI46/20, e cila mes tjerash përcakton: "164 ..Gjykata potencoi se, ratio legis i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron - në çdo rrethanë përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njërës gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënpërfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të bëhen në bazë të renditjes të kandidatëve, të cilën e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%. Në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, lidhur me formulën për ndarjen e ulëseve të Kuvendit të Komunës, si dhe numri më i vogël i kandidatëve nga gjinia e kundërt nëse numri i kandidatëve kanë fituar mandate është dy (2) atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë një pra duhet të

jen një burrë dhe një grua. Gjithashtu, edhe tek rastet kur subjekti politik ka fituar katër (4) ulëse, atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë 2 (dy), pra duhet të jenë dy burra dhe dy gra, sepse po që se do të jetë ndryshe atëherë nuk do të arrihet përfaqësimi minimal në kuotën prej 30%, i gjinisë së kundërt. Sa i përket procedurës së zëvendësimit të anëtareve të kuvendit komunal, bëhet sipas dispozitave ligjore të nenit 10 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, Udhëzimit Administrativ për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarëve të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimit në rastet KI45/20 dhe KI46/20, ku është përcaktuar se, pasi të jetë siguruar përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nën përfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e mëtejme bëhen në bazë të renditjes së kandidatëve, sipas rezultatit zgjedhor. Kuota gjinore, sipas këtij aktgjykimi, zbatohet vetëm deri në arritjen e qëllimit për të cilin është vendosur, përkatësisht për sigurimin e përfaqësimit minimal të detyrueshëm prej 30% për gjininë e nën përfaqësuar. Gjithashtu, ju njoftojmë se, bazuar në rezultatet e zgjedhjeve lokale 2025, në kuadër të subjektit politik LVV në Pejë, kandidati në listën e rirenditur, Arber Vukli, nuk ka qenë kandidati me numrin më të madh të votave për zëvendësim. Sipas rezultateve, numrin më të madh të votave e kanë pasur Gamza Sylejmani dhe Hidajete Nikçi (shih të bashkangjitur listën e rezultateve).

PZAP-i, pasi bëri vlerësimin e pohimeve të palës ankuese, përgjigjes në ankesë dhe vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit se ka moszbatim të dispozitave ligjore për zëvendësim sipas gjinisë, trajtim i pabarabartë krahasuar me rastet e tjera të zëvendësimit, gjeti se ankesa është e pabazuar sepse respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi është 50% nga kjo konstatohet se nuk është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në dispozitën e nenit 8 par.3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas par.2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik.

Në Nenin 8 par.4 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, në mënyrë decitive thuhet se : *“Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në par.3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%”*. Në nenin 10 par.3, pika c të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, në mënyrë decitive thuhet se : *“nga kandidati i radhës në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik i cili ka pasur koeficientin më të lartë të votave menjëherë pas subjektit paraprak, në pajtim me formulën e përcaktuar në nenin 7.1 të këtij ligji në zgjedhjet e fundit, në rast se nuk mbetet ndonjë kandidat tjetër në listën e rirenditur të kandidatëve të partisë politike paraprake”*.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pa bazuara, pasi që kandidatët e zgjedhur nga subjekti politik LVV, janë zgjedhur duke u bazuar në votat e marra në Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 12 Tetor 2025 në Republikën e Kosovës, në kuadër të subjektit politik LVV në Komunën e Pejës, kandidati në listën e rirenditur, Arbër Vukli, sipas listës së rezultateve të KQZ-së, nuk ka qenë kandidati me numrin më të madh të votave për zëvendësim, dhe sipas rezultateve të KQZ-së, numrin më të madh të votave e kanë pasur kandidatët për anëtare të kuvendit Komunal në Pejë, Gemza Sylejmani, dhe Hidajete Nikçi.

Paneli vlerëson se për situatë të ngjashme si në rastin konkret, ka praktikë edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka vendosur me Aktgjykimet në rastet KI45/20 dhe KI46/20 me të cilin Aktgjykim është theksuar se në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron - në çdo rrethanë -përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njërës gjini. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%".

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesën e parashtruar, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse".

Nga arsyet e theksuar më lartë duke u bazuar në nenin 8 dhe 10 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LKP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.13/2026 datë 20.02.2026

KRYESUESI PANELIT,

Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LKP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzetetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.